

# Udhëzuesi i shpejtë

Për më shumë informacion rreth përdorimit të telefonit, vizito [www.alcatel-mobile.com](http://www.alcatel-mobile.com) për të shkarkuar manualin e plotë të përdoruesit. Për më tej, në faqe mund të konsultohesh dhe me pyetjet e shpeshta.



[www.sar-tick.com](http://www.sar-tick.com)

Ky produkt plotëson kufizimet e zbatueshme kombëtare SAR prej 2,0 W / kg. Vlerat specifike maksimale SAR mund të gjenden në pjesën **Valët e radios**.


Kur e mban ose e përdor produktin pranë trupit tuaj, përdor një aksesori të aprovuar, si p.sh. këllëf, ose përndryshe mbaj një distancë 5 mm nga trupi për të siguruar pajtueshmërinë me kërkesat për ekspozimin ndaj radiofrekuencave. Ki parasysh se produkti mund të jetë duke transmetuar edhe nëse nuk je duke kryer thirrje.








## MBROJTJA E DËGJIMIT

Për të parandaluar dëmtimin e mundshëm të dëgjimit, mos dëgjo në nivele të larta volumi për periudha të gjata. Ushtro kujdes kur mban pajisjen afër veshit ndërkohë që altoparlanti është në përdorim.

# 1 Telefoni yt.....



- 1 Tasti virtual majtas
- 2 Historiku i thirrjeve (ekran jo aktiv)  
Dërgo thirrje
- 3 Posta zanore (shtypje e gjatë)
- 4 Tasti i kyçjes (shtypje e gjatë e tastit \*0#)
- 5 Tasti virtual djathtas
- 6 Ndiz/Fik  
Përfundo thirrjen
- 7 Sinjalizim me dridhje (regjimi i Dridhjes aktiv)
- 8 Tasti i shfletimit:  
Konfirmo një opsion   
Rrit volumn   
Ul volumn   
Lëviz te funksioni i majtë   
Lëviz te funksioni i djathtë 
- 9 Elektri

## 1.1 Tastet dhe lidhjet



Tasti i lundrimit  
Konfirmo një opsion (shtyp mesin e qendrës)



Tasti virtual majtas  
• Zhblokimi i tastierës  
• Hyrja te menyja kryesore



Dërgimi i thirrjes  
Hyrja te historiku i thirrjeve (në ekranin Kryesor)



Tasti virtual djathtas  
Hapja e kontakteve



Tasti i ndezjes  
• Ndezja/fikja e telefonit (shtyp gjatë)  
• Përfundimi i thirrjes  
• Kthimi te ekrani Kryesor



Në ekranin Kryesor  
• Futja e "1" (shtypje e gjatë)  
• Formimi i numrit të postës zanore (shtypje e gjatë)



Në regjim Modifikimi  
• Futja e simboleve të përdorura më shpesh  
• Futja e "1" (shtypje e gjatë)  
Në ekranin Kryesor  
• Futja e "0"  
• Futja e "+" (shtypje e gjatë). "+" përdoret për formimin e një thirrjeje ndërkombëtare.

Në regjim Modifikimi:  
• Futja e "0" (shtypje e gjatë)



Në ekranin Kryesor  
Futja e "\*"

Tastiera e kyçjes (shtypje e gjatë)

Në regjim Modifikimi  
Ndryshimi i gjuhës së hyrjes  
Hyrja në listën e mënyrës së futjes



Në ekranin Kryesor  
Futja e "#"

Aktivizimi/çaktivizimi i regjimit të dridhjes

Në regjim Modifikimi  
Shtimi i hapësirës  
Fut simbolet (shtypje e gjatë)



Në ekranin Kryesor  
Futja e "5"

Ndezja/fikja e elektrikut

## 1.2 Ikonat e statusit të njoftimit<sup>(1)</sup>



Niveli i karikimit të baterisë



Niveli i pranimit të rrjetit



Regjimi i mbledhjes: telefoni dridhet, por nuk bie zija dhe as nuk bën bip.



Regjim pa zë: telefonit tuaj nuk i bie zija, nuk bën bip dhe as nuk dridhet



Statusi i Bluetooth (aktivizuar)



Regjimi i fluturimit



Kufja e lidhur



Alarmi i orës i programuar



Thirrjet e humbura



Statusi i lidhjes GPRS



Roaming



SMS e palexuar



Mesazhet plot



Transferimi i thirrjeve

<sup>(1)</sup> Ikonat dhe ilustrimet në këtë udhëzues jepen vetëm për qëllime informative.

## 2 Fillimi .....

### 2.1 Konfigurimi

#### Heqja dhe instalimi i kapakut të pasmë



#### Heqja dhe instalimi i baterisë



#### Vendosja dhe heqja e kartës microSD



#### Vendosja dhe heqja e kartës SIM



Vendos kartën SIM me çipin për poshtë dhe rrëshqite për në fole. Sigurohu që është futur mirë. Për të hequr kartën, shtype dhe rrëshqite për jashtë.



Ndërsa modeli me një SIM, mbështet vetëm kartë mini-SIM. Mos tento të fusësh lloje të tjera SIM, si karta mikro dhe nano, sepse kjo mund të shkaktojë dëmtim të telefonit.

#### Karikimi i baterisë



- Lidhe karikuesin e baterisë me telefonin dhe fute në prizë.
- Karikimi mund të dojë rreth 20 minuta për të filluar nëse bateria është pa energji.
- Ki kujdes të mos fusësh me forcë fishtë në fole.
- Sigurohu që bateria është futur saktë para lidhjes së karikuesit.
- Priza duhet të jetë pranë telefonit dhe lehtësisht e arritshme (evito kabllo të zgjatuese elektrike).
- Këshillohet ta karikosh baterinë në maksimum nëse telefoni përdoret për herë të parë (rreth 3 orë).
- Për të reduktuar konsumin dhe humbjen e energjisë, kur bateria është karikuar plotësisht, shkëpute karikuesin nga priza; redukto kohën e dritës në sfond etj.



Karikimi ka përfunduar kur animacioni ndalon.

## 2.2 Ndezja e telefonit




Mbaj shtypur tastin  derisa telefoni të ndizet.

## 2.3 Fikja e telefonit


Mbaj shtypur butonin  nga ekrani joaktiv.

# 3 Thirrjet .....

## 3.1 Kryerja e një thirrjeje

Fut numrin e dëshiruar, më pas shtyp tastin  për të kryer thirrjen. Nëse bën një gabim, mund t'i fshish shifrat e pasakta duke shtypur tastin . Për ta mbyllur thirrjen, shtyp tastin .

### Kryerja e një thirrjeje emergjente

Nëse telefoni mbulohet nga rrjeti, formo numrin e urgjencës dhe shtyp tastin  për të kryer një thirrje urgjente. Kjo funksionon edhe pa një kartë SIM dhe pa futur kodin PIN ose shkyçur ekranin formues.

## 3.2 Thirrja e postës zanore<sup>(1)</sup>

Për të hapur postën zanore, mbaj shtypur tastin .

## 3.3 Përgjigja e një thirrjeje




Kur merr një thirrje hyrëse, shtyp tastin  për t'u përgjigjur dhe pastaj mbylle duke përdorur tastin .

## 3.4 Funksonet e disponueshme gjatë thirrjes

Gjatë një thirrjeje, mund të përdorësh numërorin, kalendarin dhe mesazhet, etj. pa e mbyllur telefonin.

# 4 Kontaktet.....

## 4.1 Referimi i kontakteve

Mund të hapësh memorien e thirrjeve duke shtypur  nga ekrani joaktiv ose shtyp tastin  dhe zgjidh ikonën  nga Menyja. Në këtë meny, do të shohësh të gjitha kontaktet me telefon.


## 4.2 Shtimi i një kontakti

Zgjidh menyën **Shto te**, më pas ruaje tek Telefoni ose karta SIM sipas dëshirës.

# 5 Historia e thirrjeve

Mund të hapësh historikun e thirrjeve duke shtypur  nga ekrani joaktiv ose shtyp tastin  dhe zgjidh ikonën  nga Menyja.


# 6 Cilësimet.....

Nga menyja kryesore, zgjidh menyën  dhe zgjidh funksionin sipas dëshirës për të personalizuar telefonin: **Cilësimet e telefonit**, **Ekrani**, **Siguria**, **Cilësimet e thirrjeve**, **Lidhjet dhe Informacioni rregullator** dhe **siguria**.

# 7 Mesazhet.....

Krijimi i mesazhit

<sup>(1)</sup> Kontakto me operatorin e rrjetit për të kontrolluar disponueshmërinë e shërbimit.

Mund të zgjedhësh **Mesazhet** nga menyja kryesore ose hyr nga miniaplikacioni  për të krijuar mesazhe teksti/multimediale. Mund të shtypësh një mesazh dhe ta dërgosh te një marrës në numërorin e kartës SIM dhe gjithashtu mund të fusësh një mesazh të paracaktuar nga "**Fut shabllonet**". Ndërsa shkruan një mesazh, zgjidh "**Opsionet**" për të hyrë te të gjitha opsionet e mesazheve.



Një mesazh SMS me më shumë shkronja se sa lejohet (numri i shkronjave varet nga gjuha) do të tarifohet si disa SMS. Shkronjat specifike (me theks) do të rrisin përmasat e SMS-së, kjo mund të bëjë që marrësit t'i dërgohen disa SMS.

## 8 Profilet .....

Telefoni yt ofron disa profile përdoruesish, mund të personalizosh disa cilësime për t'iu përshtatur ngjarjeve dhe mjediseve specifike.

## 9 Lojërat .....

Në telefon ndodhen shtatë lojëra të tituluara **Bubble Bash 2**, **Ninja Up**, **Sky Gift**, **Danger Dash**, **Nitro Racing**, **Block Breaker** dhe **Air Strike**. Për më shumë informacion, referojuni menyse "Ndihma" në secilën lojë.




## 10 Kamera .....

Telefoni celular është i pajisur me një kamera për të bërë fotografi dhe për të regjistruar video:

- Ruaji ato si krijime në kartën microSD ose në telefon.
- Dërgoju ato me një mesazh multimedial (MMS) te një telefon celular.
- Dërgoju ato direkt nëpërmjet MMS, Bluetooth.
- Personalizo ekranin Kryesor.

- Transferoju ato nëpërmjet kablos së të dhënave ose kartës microSD te kompjuteri.

## 11 Video .....

Mund të fusësh ndërfaqen e regjistrimit DV përmes kësaj menyje direkt. Shtyp tastin  për të nisur regjistrimin dhe shtyp tastin  për më shumë opsione dhe cilësime. Mund të kalosh mes regjimit të Kamerës dhe regjimit të Videos përmes **Opsionet/ Më shumë opsione**, ose thjesht shtyp të majtën ose të djathtën në tastin .




## 12 Skedarët.....

Telefoni ofron hapësirë të caktuar për ty që të menaxhosh skedarët dhe të mbështetësh kartën microSD. Kapaciteti i kartës microSD është i përzgjedhshëm. Mund të krijosh një dosje të re dhe të fshish, redaktosh, kërkohsh, shënosh dhe shikosh detajet e dosjeve ose skedarëve ekzistues.



## 13 Muzika.....

Hape këtë funksion nga menyja kryesore duke zgjedhur "**Muzika**".

Ke liri të plotë për të menaxhuar muzikën edhe në telefon, edhe në kartën microSD.

Përdore këtë funksion për të luajtur skedarë audio. Shtyp tastin  për të luajtur/vendosur në pauzë audion; shtyp shkurt majtas ose djathtas në tastin  për audion e mëparshme ose të radhës, shtyp lart ose poshtë tastin  për të rregulluar volumin.

## 14 Galeria e videove...

Përdore këtë funksion për të luajtur skedarë video. Shtyp tastin  për të luajtur/vendosur në pauzë videon, shtyp shkurt lart ose poshtë tastin  për të rregulluar volumnin.

## 15 Galeria e fotove ....

Imazhet e tua ruhen në bibliotekën "Galeria e fotove" në telefon ose në kartën microSD. Këtu, mund të zgjedhësh **Vendose si sfond**, **Fshi**, **Ndaj** me MMS dhe Bluetooth, **Shëno**, **Riemërto** dhe **Prezantim**.

## 16 Makina llogaritëse.

Fut numra dhe zgjidh llojin e funksionit duke përdorur tastin e Navigimit siç do të bëje me një makinë llogaritëse standarde.

Shtyp butonin e Majtë për të rifilluar llogaritjen.

## 17 Radio FM.....

Telefoni është i pajisur me një funksion<sup>(1)</sup> radioje. Mund ta përdorësh aplikacionin si radio tradicionale dhe të regjistrosësh kanalën e sintizonizuar aktualisht. Mund ta dëgjosh atë ndërkohë që ekzekuton aplikacione të tjera.

<sup>(1)</sup> Cilësia e radios varet nga mbulimi me valë i stacionit të radios në atë zonë të caktuar.

## 18 Shfletuesi.....

Ky funksion të mundëson të lundrosh në internet me telefon dhe të personalizosh preferencën tënde.

Shënim: Këshillohu me operatorin lokal të rrjetit për tarifën përkatëse dhe konfigurime specifike.

## 19 Kalendari .....

Pasi hyn në këtë meny nga menyja kryesore, ka një kalendar me pamje mujore që të shikosh mbledhjet e rëndësishme, takimet, etj. Ditët me alarm zazor të regjistruar do të shënohen.

## 20 Libri elektronik.....

Këtu mund të lexosh dhe të menaxhosh dokumentin dixhital me tekst.

## 21 Bluetooth.....

Mund të shkëmbesh të dhëna, si p.sh. video, imazhe dhe audio, me pajisjet e tjera të mbështetura brenda një rrezeje të kufizuar pas çiftimit.

## 22 Regjistruesi.....

Hapja e **Regjistruetit** të lejon të bësh regjistrime të zërit ose tingujve. Telefoni yt mbështet skedarët e formateve AMR, MP3 dhe WAV. Një skedar i regjistruar i ndaluar do të ruhet automatikisht te **Lista e skedarëve të regjistruar**

## 23 Konvertimi.....

Kur zgjidhet **pesha**, mund të kontrollosh me shpejtësi diferencën mes vlerave kg-paund dhe kg-onz. Kur zgjidhet **gjatësia**, mund të konvertosh mes vlerave km-milje, m-jard, m-këmbë, and cm-inç.

## 24 Shënimet.....

Mund të krijosh shënime në formatin tekst dhe t'i menaxhosh ato duke hapur "**Shënimet**" nga menyuja kryesore.

## 25 Alarm .....

Telefoni yt ka një alarm ore të inkorporuar me funksion dremitje. Mund të caktosh pesë alarme me orë zgjimi dhe opsione të tjera të personalizueshme.

## 26 Thirrja e rreme .....

Ky program të jep mundësinë t'i telefonosh vetes duke simuluar numrin/emrin e një telefonuesi, zilen në një orë të programuar. Kjo të ndihmon që

me delikatesë të dalësh nga situatat sociale në çdo kohë që dëshiron. Ky

thirrje mund të refuzohet me tastin Përfundo.

## 27 Alarmi zanor.....

Me këtë meny, mund të krijosh skedarin zanor dhe ta vendosësh si

alarm.

## 28 Ora botërore.....

Ora e parë shfaq orën bazuar në vendndodhjen tënde kur konfiguron telefonin. Mund të shtosh qytete të tjera për të shfaqur orën në zonat e tyre kohore.

## 29 Kohëmatësi .....

Mund të përdorësh **Kohëmatësi** për të numëruar mbrapsht duke filluar nga një interval i specifikuar kohor. Shtyp tastin  për të nisur numërimin.

## 30 Elektriку .....

Telefoni yt ka një elektrik të integruar. Mund ta ndezësh/fikësh atë përmes "**Elektriku**" te menyja kryesore.

Në ekranin Kryesor, duke shtypur dhe mbajtur shtypur tastin  gjithashtu mund të ndezë/fikë elektrikun.

## 31 Filtri i thirrjeve.....

Aktivizo listën e ndalimeve për të bllokuar automatikisht të gjithë telefonuesit në listën e ndalimeve. Aktivitizimi i listës së lejimeve do të lejojë vetëm thirrjet nga numrat e listuar në listën e lejimeve.



## 32 STK .....



Telefoni yt mbështet funksionin STK (SIM Tool Kit). Elementët specifikë varen nga lloji i kartës SIM dhe rrjeti. Menyja e shërbimit do të shtohet automatikisht në menyën e telefonit kur të mbështetet nga rrjeti yt dhe karta SIM.

Kontakto me operatorin e rrjetit për të kontrolluar disponueshmërinë e shërbimit.

## Siguri dhe përdorim.....

Në rekomandojmë që ju të lexoni këtë kapitull me kujdes para përdorimit të telefonit tuaj. Prodhuesi nuk merr përsipër asnjë përgjegjësi për dëmin, që mund të rezultojë si pasojë e përdorimit të papërshtatshëm ose përdorim në kundërshtim me udhëzimet e përfshira këtu.

### • SIGURI TRAFIKU:

Duke patur parasysh se studimet tregojnë se duke përdorur një telefon celular, ndërsa ngisni automjetin përbën një rrezik të vërtetë, madje edhe kur është përdorur pajisja në regjimin pa duar (pajisje makine, kufje ...), shoferëve u kërkohet që të shmangin përdorimin e celularit të tyre kur automjeti nuk është i parkuar.

Gjatë drejtimit, mos përdorni telefonin tuaj dhe kufjet për të dëgjuar muzikën ose radion. Të përdorësh një kufje telefoni mund të jetë e rrezikshme dhe e ndaluar në disa zona.

Kur telefoni juaj është i ndezur, lëshon rreze elektromagnetike që mund të ndërhyjë me sistemin elektronik të automjetit të tillë si ABS, bllokimin e frenave ose jastëkëve të ajrit. Për tu siguruar që nuk ka asnjë problem:

- mos vendosni telefonin tuaj sipër panelit të aparaturave ose brenda zonës së shpërndarjes së jastëkëve të ajrit,
- kontrolloni me tregtarin tuaj të makinës ose prodhuesin e makinës për tu siguruar që paneli i aparaturave është i mbrojtur në mënyrë adekuate nga energjia RF e telefonit celular.

### • KUSHTET E PËRDORIMIT:

Ju këshilloheni të fikni telefonin tuaj kohë pas kohe për të rregulluar performancën e tij.

Fikni telefonin tuaj para hipjes në bordin e një avioni.

Fikni telefonin kur jeni në objekte të kujdesit shëndetësor, me përjashtim të zonave të caktuara. Ashtu si me shumë lloje të tjera të pajisjeve tani në përdorim të rregullt, telefonat celularë mund të ndërhyjnë me pajisje të tjera elektrike ose elektronike, ose pajisje që përdorin radio frekuenca.

Fikni telefonin kur jeni pranë gazit ose lëngjeve të ndezshme. Zbatoni saktësisht të gjitha shenjat dhe udhëzimet e afishuara në një depo karburanti, stacion karburanti ose fabrikë kimike ose në ndonjë ambient potencialisht shpërthyes.

Kur telefoni është i ndezur, ai duhet të mbahet të paktën 15 cm nga çdo pajisje mjekësore të tillë si një stimulus kardiak, një aparat dëgjimi ose pompë insuline, etj. Në veçanti kur përdorni telefonin, ju duhet ta mbani atë kundër veshit në anë të kundërt të pajisjes.

Për të shmangur dëmtim e dëgjimit, merrni thirrjen përpara se të mbani telefonin tuaj në veshin tuaj. Gjithashtu lëvizni telefonin larg nga veshi juaj kur jeni duke përdorur regjimin "pa duar" sepse përforcimi i vullmit mund të shkaktojë dëmtime të dëgjimit.

Mos lejoni fëmijët të përdorin telefonin dhe/ose të luajnë me telefon dhe aksesorë pa mbikëqyrje.

Kur rivendosni kapakun ju lutem vini re se telefoni juaj mund të përmbajë substanca të cilat mund të krijojnë një reaksion alergjik.

Gjithmonë trajtojeni me kujdes telefonin dhe aksesorët e tij dhe mbajni në një vend të pastër dhe pa pluhur.

Mos lejoni që telefoni juaj të jetë i ekspozuar ndaj motit të pafavorshëm ose të kushteve mjedisore (njomësi, lagështi, shi, infiltrim lëngshes, pluhur, ajri i detit, etj). Kufiri i temperaturës së funksionimit i rekomanduar nga prodhuesi është nga -10°C (14°F) në +55°C (131°F).

Mbi +55°C (131°F) leximi i ekranit të telefonit mund të jetë i dobët, megjithëse kjo është e përkohshme dhe jo serioze.

Thirrja e numrave të emergjencës mund të jetë e paarritshme në të gjithë rrjetet celular. Kurrë nuk duhet të mbështeteni vetëm te telefoni juaj për thirrjet e emergjencës.

Mos e hapni, zbrërtheni apo të mundoheni ta riparoni vetë telefonin tuaj celular.

Mos e hidhni, flakni apo thyeni telefonin tuaj celular.

Për të shmangur ndonjë plagosje mos e përdorni telefonin nëse xhami me të cilin është bërë ekran, është dëmtuar, krisur apo i thyer. Mos e lyeni atë.

Përdorni vetëm bateri, karikues baterie, dhe aksesorë të cilët janë të rekomanduar nga TCL Communication Ltd dhe degëve të saj dhe që janë të pajtueshëm me modelin e telefonit tuaj. TCL Communication Ltd dhe degët e saj refuzojnë çdo përgjegjësi për dëmtime të shkaktuara nga përdorimi i karikuesve apo baterive të djera.

Kujtohuni të bëni kopje rezervë ose ruani një regjistrim të shkruar për të gjithë informacionin e rëndësishëm të ruajtur në telefonin tuaj. Disa njerëz mund të vuajnë kriza epileptike apo verbim kur janë të ekspozuar nga blci. Këto kriza apo verbime mund të ndodhin edhe nëse një person nuk ka pasur kriza apo verbime më parë. Nëse keni provuar kriza apo verbime, ose nëse keni një histori familjare të ngjarjeve të tilla, ju lutemi konsultohuni me doktorin tuaj përpara se të aktivizoni një funksion të dritës së blcicit në telefonin tuaj.

Prindërit duhet të monitorojnë përdorimin nga fëmijët e tyre të lojërave video apo të veçorive të tjera që përmbajnë blcic në telefonin tuaj. Të gjithë njerëzit duhet të ndërpresin përdorimin dhe të konsultohen me doktorin nëse ndonjë nga simptomat e mëposhtme ndodhin: konvulsione, dridhje sysh ose muskujsh, humbje ndërgjegjësimi, lëvizje të pavullnetshme, ose mos orientim. Për të limituar mundësinë e këtyre simptomave, ju lutemi merrni masat e sigurisë që vijojnë:

- Mos luani ose mos përdorni tiparet e blcicit nëse jeni i lodhur apo keni nevojë të flini.

- Merrni një pushim minimum prej 15-minuta për orë.

- Luani në një dhomë ku të gjithë dritat janë të ndezura.

- Luani në distancën më të largët të mundshme nga ekrani.

- Nëse duart tuaja, kyçet, ose krahët lodhen ose lëndohen ndërkohë që luani, ndaloni dhe pushoni për disa orë përpara se të luani përsëri.

- Nëse vazhdoni të keni lëndime duarsh, kyçesh, apo krahësh gjatë ose pas lojës, ndaloni lojën dhe shkoni te doktori.

Kur luani lojëra në telefonin tuaj, ju mund të provoni parehati të rastit në duart tuaja, krahë, shpatulla, qafë, apo pjesë të tjera të trupit tuaj. Ndiqni instruksionet për të shmangur probleme si inflamacion të muskullit të glicës, sindromë së tunelit të kyçit, ose çrregullimeve të tjera të muskujve apo skeletit.

#### • PRIVATËSIA:

Ju lutem vini re se ju duhet të respektoni ligjet dhe rregullat në fuqi në juridiksionin tuaj dhe juridiksione të tjera ku ju do të përdorni telefonin tuaj celular në lidhje me bërje fotografish dhe regjistrim zëri me telefonin tuaj celular. Sipas këtyre ligjeve dhe rregullave, mund të jetë rreptsisht e ndaluar të bësh fotografi dhe/ose të regjistros zërin e njerëzve të tjerë apo atributave personale të tyre, si dhe të kopjosh ose ti shpërndash ato, pasi kjo mund të konsiderohet si shkelje e privatësisë. Është përgjegjësi vetëm e përdoruesit të garantojë që autorizimi paraprak është arritur, nëse nevojitet, në mënyrë që të regjistrojë biseda private ose sekrete apo të bëjë foto të një personi tjetër; prodhuesi, shitësi ose pala shitëse i telefonit tuaj (përfshirë operatorin) heqin dorë nga çdo përgjegjësi e cila vjen nga përdorimi jo i duhur i telefonit tuaj.

#### • BATERIA:

Bazuar në rregullonet e fluturimit, bateria e produktit nuk është karikuar. Karikojë atë në fillim.

Para heqjes së baterisë nga telefoni juaj, ju lutem sigurohuni që telefoni është fikur.

Vëreni masat që vijojnë për përdorimin e baterisë:

- Mos u përqipni të hapni baterinë (për shkak të rrezikut të tymit toksik dhe djegjes).

- Mos shpioni, zbrërtheni ose shkaktoni një qark të shkurtër në bateri.

- Mos djigini ose ekspozoni një bateri të përdorur në mbeturinat e shtëpisë ose ta ruani në temperaturë mbi 60°C.

Bateritë duhet të asgjësohen në përputhje me rregullat lokale të aplikuarra për mjedisin. Përdoreni baterinë vetëm për qëllimin për të cilin është bërë. Kurrë mos përdorni bateri të dëmtuara ose jo të rekomanduara nga TCL Communication Ltd dhe/ose degëve të saj.

Ky simbol në telefonin tuaj, në bateri dhe aksesore do të thotë se këto produkte duhen dërguar në pikat e grumbullimit në fund të jetës së tyre:

- Qendrat e mbetjeve të bashkisë me kazanë specifike për këto lloje pajisjesh.

- Koshat e grumbullimit në pikat e shitjes.

Ato më pas duhet të riciklohen, duke parandaluar që substancat të hidhen në mjedis dhe në mënyrë që përbërësit e tyre të mund të ripërdoren.

### Në shtetet e Bashkimit Evropian:

Pikat e grumbullimit janë të arritshme pa pagesë.

Të gjitha produktet me këtë shenjë duhen dërguar në këto pika grumbullimi.

### Në juridiksionet jashtë Bashkimit Evropian:

Artikujt e pajisjeve me këtë simbol nuk duhen hedhur në kabinatë e zakonshëm nëse në juridiksionin ose rajonin tuaj ka fabrika të përshtatshme grumbullimi dhe riciklimi; përkundrazi ato duhet të dërgohen në pikat e grumbullimit që të riciklohen.

**KUJDES:** RREZIKU SHPËRTHIMI NËSE BATERIA ZËVENDËSOHET ME NJË LLOJ TË PASAKTË. HIDHINI BATERITË E PËRDORURA NË PËRPUTHJE ME INSTRUKSIONET.

### KARIKUESIT

Karikuesit kryesorë do të operojnë me një temperaturë që shtrihet nga: 0°C në 40°C.

Karikuesit e projektuar për telefonin tuaj celular plotësojnë kriterin për sigurinë e informacionit të pajisjeve të teknologjisë dhe zyrës së përdorimit të pajisjeve. Ata janë gjithashtu në përputhje me direktivën e projektimit eko 2009/125/EC. Sipas specifikimeve elektrike të ndryshme të zbatimit, një karikues i blerë nga ju në një juridiksion mund të mos punojë në një juridiksion tjetër. Ata duhet të përdoren vetëm për këtë qëllim.

Për shkak të materialit të mbyllur të përdorur, telefoni celular duhet të lidhet vetëm të një ndërfaqe USB të versionit 2.0 ose më të lartë. Lidhja me të ashtuquajturën USB e fuqishme është e ndaluar. Përshtatësi duhet të instalohet pranë pajisjes dhe duhet të jetë lehtë i arritshëm. Ky karikues është vetëm për përdorim shtëpiak.

## VALËT E RADIOS:

Dëshmia e pajtueshmërisë me kriteret ndërkombëtare (ICNIRP) ose me Direktivat Evropiane 2014/53/EU (RED) është e nevojshme për të gjithë modelet e telefonave celularë përpara se ato të hidhen në treg. Mbrojtja e shëndetit dhe siguria për përdoruesin dhe për çdo person tjetër është një kërkesë thelbësore e këtyre kriterëve ose kësaj direktive.

### KJO PAJISJE PËRMBUSH UDHËZIMET NDËRKOMBËTARE PËR EKSPOZIMIN NDAJ VALËVE TË RADIOS

Pajisja juaj celulare është një radio transmetuese dhe radio marrëse. Ajo është projektuar të mos kapërcëjë kufijtë e ekspozimit ndaj valëve të radios (fushave elektromagnetike të frekuencave të radios) të rekomanduara nga udhëzimet ndërkombëtare. Këto udhëzime janë hartuar nga organizata e pavarur shkencore (ICNIRP) dhe përbajnë kufijtë e sigurisë të përcaktuar për të garantuar mbrojtjen e të gjithë personave, pavarësisht moshës dhe gjendjes shëndetësore.

Udhëzimet e ekspozimit ndaj valëve të radios përdorin një njësi matëse të njohur si koeficienti specifik i absorbimit, ose SAR. Kufiri SAR për pajisjen celulare është 2 W/kg.

Testet për SAR janë kryer duke përdorur pozicionet standarte operative me transmetimin e pajisjes në nivelin më të lartë të certifikuar në të gjithë bandat e frekuencave të provuara. Vlerat më të larta SAR sipas udhëzimeve të ICNIRP për këtë model pajisje janë: **2038X:**

Maksimumi SAR për këtë model dhe kushtet sipas të cilave ishte regjistruar.		
Koka SAR	GSM 900 + Bluetooth	1.77 W/kg
Trup-i veshur SAR	UMTS 2100 + Bluetooth	1.68 W/kg

Gjatë përdorimit, vlerat aktuale SAR për këtë pajisje janë zakonisht edhe më poshtë se vlerat e deklaruara më sipër. Kjo është sepse, për qëllimin e efikasitetit të sistemit dhe për të minimizuar interferencën në rrjet, fuqia operative e pajisjes suaj celulare është ulur automatikisht kur e gjithë fuqia nuk është e nevojshme për telefonatën. Sa më e ulët energjia e nxjerrë nga pajisja, aq më e vogël është vlera SAR.

Provata SAR për afër trupit janë kryer në një distancë ndarëse prej 5 mm. Për të plotësuar udhëzimet ndaj ekspozimit RF gjatë veprimeve me afër trupit, pajisja duhet të pozicionohet minimumi në këtë distancë larg trupit.

Nëse nuk jeni duke përdorur një pajisje shtesë të aprovuar sigurohuni që çfarëdo produkti që po përdoret është pa asnjë metal dhe e pozicionon telefonin larg trupit në distancën e treguar.

Organizata të tilla si Organizata Botërore e Shëndetësisë dhe Administrata amerikane për ushqimet dhe ilaçet kanë deklaruar se njerëzit që janë të shqetësuar dhe duan të reduktojnë ekspozimin e tyre ata mund të mund të përdorin një pajisje pa duar që ta mbajnë telefonin larg nga koka dhe trupi gjatë thirrjeve të telefonatave, ose të reduktojnë kohën e shpenzuar në telefon.

Për më shumë informacion ju mund të shkoni te [www.alcatel-mobile.com](http://www.alcatel-mobile.com)

Informacion shtesë rreth fushave elektromagnetike dhe shëndetit publik janë të mundshme në sitin që vijon:<http://www.who.int/peh-emf>.

Telefoni juaj është i pajisur me një antenë/ Për operim optimal, ju duhet ta shmangni ose pakësoni prekjën e saj.

Meqë pajisjet celulare ofrojnë një gamë funksionesh, ata mund të përdoren në pozicione të tjera përveç se përkundrejt veshit tuaj. Në rrethana të tilla pajisja do të jetë në përputhje me udhëzimet kur përdoret me kufje ose kablo usb të dhënash. Nëse jeni duke përdorur një pajisje shtesë sigurohuni që çfarëdo produkti që po përdoret të jetë pa asnjë metal dhe që e pozicionon telefonin së paku 5 mm larg trupit.

Ju lutem kini parasysh se duke përdorur pajisjen disa nga të dhënat tuaja personale mund të ndahen me pajisjen kryesore. Është nën përgjegjësinë tuaj të mbronit të dhënat tuaja personale, mos t'i ndani me pajisje të paautorizuara ose pajisje të palëve të treta të lidhura me pajisjen tuaj. Për produkte me veçori Wi-Fi, lidhuni vetëm me rrjete të besuara Wi-Fi. Gjithashtu kur përdorni produktin tuaj si një pikë lëvizëse hyrëse (kur është e disponueshme), përdorni siguri rrjeti. Këto masa paraprake do ju ndihmojnë të parandaloni hyrje të paautorizuara në pajisjen tuaj. Produkti juaj mund të ruajë informacion personal në vendndodhje të ndryshme përfshirë një kartë SIM, kartë kujtese dhe.

kujtesën e inkorporuar. Jini i sigurt të hiqni ose pastroni gjithë informacionin personal para riciklimit rikthimit, ose përpara se të falni produktin tuaj. Zgjidhni aplikacionet tuaja dhe përditësimet me kujdes dhe instaloni vetëm nga burimet e besuara. Disa aplikacione mund të ndikojnë në performancën e produktit tuaj dhe/ose të kenë qasje në informacionin privat përfshirë detajet e llogarisë, të dhënat e thirrjes, detajet e vendndodhjes dhe burimet e rrjetit.

Vini re se çdo e dhënë e ndarë me TCL Communication Ltd. është e ruajtur në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave. Për këto qëllime TCL Communication Ltd. zbaton dhe mirëmban masat e duhura teknike dhe organizative për të mbrojtur të gjitha të dhënat personale, për shembull kundër përpunimit të paautorizuar apo të paligjshëm dhe humbjes aksidentale ose shkatërrimit apo dëmtimit e të dhënave të tilla personale ku masat do të sigurojnë një nivel të sigurisë që është i përshtatshëm duke pasur parasysh

(i) mundësitë teknike të disponueshme,

(ii) koston për zbatimin e masave,

(iii) rreziqet e përfshira me përpunimin e të dhënave personale dhe,

(iv) ndjeshmëria e të dhënave personale të përpunuara.

Ju mund të hapni, shqyrtoni dhe të redaktoni të dhënat tuaja personale në çdo kohë duke hyrë në llogarinë tuaj të përdoruesit, duke vizituar profilin tuaj të përdoruesit apo duke na kontaktuar direkt. Nëse ju na kërkon të redaktojmë ose fshijmë të dhënat tuaja personale, ne mund t'ju kërkojmë të na jepni dëshmi të identitetit tuaj para se ne mund të veprojme sipas kërkesës tuaj.



Logoja microSD është një markë tregtare.



Logot dhe markat e Bluetooth janë pronë e Bluetooth SIG, Inc. dhe çdo përdorim i këtyre markave nga TCL Communication Ltd. dhe filialet e saj bëhet me licencë. Markat e tjera tregtare dhe emrat e tjerë tregtarë janë pronë e pronarëve të tyre përkatës.

alcatel 2038 Bluetooth Declaration ID B020196

Kjo pajisje mund të përdoret në të gjitha vendet evropiane.

BE	BG	CZ	DK	EE	IE	EL	ES	FR	HR	IT	CY	LV	
LT	LU	HU	MT	NL	AT	PL	PT	RO	SI	SK	FI	SE	UK

Përmes kësaj na theksojmë se garancia e përdoruesit përfundimtar për shkeljen e DPI-së është e kufizuar vetëm për BE-në.

Nëse dhe deri në shkallën që Produkti eksportohet, merret ose përdoret nga përdoruesi përfundimtar jashtë BE-së, skadon çdo përgjegjësi, garanci apo dëmshpërblim nga prodhuesi dhe furnitorët e tij, në lidhje me Produktin (duke përfshirë çdo dëmshpërblim në lidhje me shkeljen e DPI-së).

# Informacion i përgjithshëm

- **Adresa e Internetit:** [www.alcatel-mobile.com](http://www.alcatel-mobile.com)
- **Numri i ndihmë së shpejtë:** shih fletushkën e "TCL Communication Services" ose shkoni në faqen tonë ueb.
- **Prodhuesi:** TCL Communication Ltd.
- **Adresa:** 5/F, Building 22E, 22 Science Park East Avenue, Hong Kong Science Park, Shatin, NT, Hong Kong.  
Në faqen tonë të internetit, ju do të gjeni sektorin tonë FAQ (Pyetjet e Kërkuara më Shpesh). Ju gjithashtu mund të na kontaktoni me postë elektronike për të pyetur për çdo pyetje që mund të kenë. Kjo pajisje radioje funksionon me brezat e frekuencës dhe fuqinë maksimale të radio-frekuencës si më poshtë:  
GSM900: 33.5dBm  
GSM1800: 30.5 dBm  
UMTS 900/2100: 24 dBm  
Bluetooth: < 2 dBm

Përmes kësaj deklarate, TCL Communication Ltd. deklaroi se pajisja e radios e llojit Alcatel 2038X është në përputhje me Direktivën 2014/53/EU. Teksti i plotë i deklaratës së konformitetit të BE-së disponohet në adresën e mëposhtme të internetit: [http://www.alcatel-mobile.com/EU\\_doc](http://www.alcatel-mobile.com/EU_doc).

Përshkrimi i aksesorëve dhe komponentëve, duke përfshirë softuerët, të cilët u lejojnë pajisjeve të radios që të funksionojnë sipas qëllimit të tyre, mund të merret në tekstin e plotë të deklaratës së konformitetit të BE-së në adresën e mëposhtme të internetit: [http://www.alcatel-mobile.com/EU\\_doc](http://www.alcatel-mobile.com/EU_doc).

## • Mbrojtja ndaj vjedhjes ®

Telefoni juaj identifikohet nga IMEI (numri i serisë së telefonit) që tregohet në etiketën e paketimit dhe në memorien e telefonit. Ne rekomandojmë që ta mbani shënim numrin herën e parë që përdorni telefonin, duke futur \* # 0 6 # dhe ta ruani atë në vend të sigurt. Ky numër mund të kërkohet nga policia ose operatori nëse ju vjedhin telefonin. Ky numër bën të mundur që celulari të bllokohet, duke penguar përdorimin e tij nga një person tjetër, qoftë edhe me kartë tjetër SIM.

(1) Kontaktoni me operatorin e rrjetit tuaj për të kontrolluar disponueshmërinë e shërbimit.

## Deklarim për mos-mbajtje përgjegjësi

Midis përshkrimit në manualin e përdoruesit dhe në funksionimin e telefonit tuaj mund të ketë disa ndryshime, në varësi të versionit të softuerit të telefonit tuaj ose të shërbimeve të veçanta të operatorit. TCL Communication nuk do të mbajë përgjegjësi për këto ndryshime, nëse ka, as për pasojat e mundshme të tyre, përgjegjësi e cila do të mbahet ekskluzivisht nga operatori.

## Garanci .....

Telefoni juaj është i garantuar ndaj çdo defekti që mund të ndodhë në kushte të përdorimit normal gjatë periudhës së garancisë të dymbëdhjetë (12) muajve<sup>(1)</sup> nga data e blerjes siç tregohet në faturën tuaj origjinale.

Bateritë<sup>(2)</sup> dhe aksesorët shitur me telefonin tuaj janë gjithashtu të garantuara ndaj çdo defekti që mund të ndodhë gjatë gjashtë (6) muajve të parë <sup>(1)</sup> nga data e blerjes siç tregohet në faturën tuaj origjinale.

Në rast të ndonjë defekti të telefonit tuaj që ju pengon nga përdorimi normal i tij, ju duhet të informoni menjëherë shitësin tuaj dhe të paraqitni telefonin tuaj me provën tuaj të blerjes.

Nëse defekti konfirmohet, telefoni juaj ose pjesë prej tij ose do të zëvendësohen ose do të rregullohen, siç duhet. Telefoni i riparuar dhe aksesorët kanë të drejtë një (1) muaj garanci për të njëjtin defekt. Riparimi ose zëvendësimi mund të kryhet duke përdorur komponentë të rinovuara nëpërmjet aparatsh që ofrojnë funksionalitet të njëjtë.

Kjo garanci mbulon koston e pjesëve dhe punëve por përjashton çdo kosto tjetër.

Kjo garanci nuk do të aplikohet për defekte të telefonit tuaj dhe/ose aksesorë ve për shkak të (pa ndonjë limitim):

- 1) Mos përputhje me udhëzimet për përdorimin apo instalimin, ose me standardet teknike dhe të sigurisë të aplikueshme në zonën gjeografike ku telefoni juaj është përdorur,
- 2) Lidhja për çdo pajisje jo të furnizuar ose jo të rekomanduar nga TCL Communication Ltd,
- 3) Modifikimi ose riparimi i kryer nga individë të pa autorizuar nga TCL Communication Ltd ose degë të tij ose shitësi juaj,
- 4) Modifikim, përshtatje ose ndryshim të programit ose pjesës fizike kryer nga individë të pa autorizuar nga TCL Communication Ltd,

<sup>(1)</sup> Periudha e garancisë mund të ndryshojë në varësi të shtetit.

<sup>(2)</sup> Jeta e një baterie të rikarikueshme të telefonisë celulare në drejtim të kohës së bisedës, kohës së gatishmërisë dhe jetës totale të shërbimit, do të varet nga kushtet e përdorimit dhe konfigurimit të rrjetit. Bateritë duke u konsideruar furnizime shpenzuese, statusi i specifikeve që ju duhet për të marrë performancën optimale për telefonin tuaj gjatë gjashtë muajve të parë pas blerjes dhe rreth 200 ose më shumë rikarikimeve.

5) Moti me shi, rrufe, zjarri, lagështia, infiltrimi i lëngjeve ose ushqimeve, produkte kimike, shkarkimi i dosjeve, përplasje, tension i lartë, korrozioni, oksidimi ...

Telefoni juaj nuk do të riparohet në rast se etiketat apo numrat serik (IMEI) janë hequr ose ndryshuar.


Nuk ka garanci të shprehura, me shkrim, verbale apo të nënkuptuara, përveç kësaj garancie të kufizuar ose garanci të detyrueshme dhënë nga vendi apo juridiksioni juaj.

Në asnjë rast TCL Communication Ltd apo ndonjë nga filialet e saj do të jetë përgjegjëse për dëmet indirekte, të rastësishme ose rrjedhimore të çfarëdo natyre, duke përfshirë por jo kufizuar humbje komerciale apo financiare ose dëmtim, humbje të të dhënave apo humbjen e imazhit në masën e plotë ato dëmtime mund të hidhen poshtë me ligj.

Disa vende/shtete nuk lejojnë përjashtimin ose kufizimin e dëmeve indirekte, të rastësishme ose rrjedhimore, ose kufizimet në kohëzgjatjen e garancive të nënkuptuara, kështu që kufizimet ose përjashtimet nuk mund të zbatohen për ju.

## Zgjidhja e problemeve .....

Para se të kontaktoni qendrën e shërbimit, ju këshilloheni të ndiqni instruksionet më poshtë:


- Ju këshilloheni të karikoni plotësisht (  ) baterinë për funksionim optimal.
- Shmangni ruajtjen e sasive të mëdha të të dhënave në telefonin tuaj pasi kjo mund të ndikojë në performancën e tij.
- Mund ta rivendosësh duke shtypur gjatë tastin # dhe tastin e ndezjes/fikjes kur je në regjim fikjeje, TË GJITHA të dhënat e telefonit të përdoruesit: kontaktet, mesazhet dhe skedarët do të humbasin përgjithmonë. Rekomandohet së tepërmi t'i ruash të gjitha të dhënat e telefonit dhe të profilit përpara se të kryesh formatimin.

dhe ndërmerrni kontrollat vijuese:

### Telefoni nuk ndizet

- Kontrolloni kontaktet e baterisë, hiqni dhe riinstalojeni baterinë tuaj, më pas ndizni telefonin tuaj.
- Kontrolloni nivelin e fuqisë së baterisë, karikoni për të paktën 20 minuta.
- Nëse ende nuk punon, rivendose telefonin duke përdorur tastin e energjisë dhe tastin #.

### Telefoni ka ngecur ose nuk përgjigjet për disa minuta

- Rindize telefonin duke shtypur dhe mbajtur tastin .
- Hiq baterinë dhe rifute, dhe rindize telefonin.
- Nëse ende nuk punon, rivendose telefonin duke përdorur tastin e energjisë dhe tastin #.

### Telefoni im fiket vetë

- Sigurohu që tasti i fikjes nuk bën kontakt të gabuar.
- Kontrolloni nivelin e karikimit të baterisë.
- Nëse ende nuk punon, rivendose telefonin duke përdorur tastin e energjisë dhe tastin #.

### Telefoni im nuk karikohet si duhet

- Sigurohuni që po përdorni një bateri alcatel dhe karikues nga kutia.
- Pastro kontaktin e baterisë nëse ka papastërti.
- Sigurohu që bateria është futur siç duhet përpara lidhjes së karikuesit.
- Sigurohuni që bateria nuk është plotësisht e shkarkuar, nëse fuqia e baterisë është bosh për një kohë të gjatë, duhen rreth 20 minuta të shfaqet indikatori i karikimit të baterisë në ekran.

- Sigurohuni që karikuesi mbahet në kushte normale (0°C në +40°C).
- Kur jeni jashtë, kontrolloni nëse voltazhi hyrës është i pajtueshëm.

### **Telefoni im nuk mund të lidhet në një rrjet ose "Asnjë shërbim" është shfaqur**

- Përpiquuni të lidheni në një tjetër vendndodhje.
- Verifikoni mbulimin e rrjetit me operatorin tuaj.
- Kontrolloni me operatorin tuaj që karta juaj SIM është e vlefshme
- Përpiquuni të zgjidhni rrjetin(et) e disponueshme manualisht.
- Përpiquuni të lidheni në një kohë më vonë nëse rrjeti është i mbingarkuar.


### **Telefoni nuk mund të lidhet në internet**

- Kontrolloni që numri IMEI (shtyp \*#06#) është i njëjtë me atë të printuar në fletën e garancisë ose në kuti.
- Sigurohuni që shërbimi i hyrjes në internet i kartës SIM është i disponueshëm.
- Kontrolloni cilësimet e lidhjes në internet të telefonit.
- Sigurohu që je në vend me mbulim nga rrjeti.
- Përpiqu të lidhesh më vonë ose në një vend tjetër.

### **Kartë e pavlefshme SIM**

- Sigurohuni se karta SIM është futur saktë (shihni "Futja ose heqja e kartës SIM").
- Sigurohuni që çipi në kartën tuaj SIM nuk është dëmtuar ose gërvishtur.
- Sigurohuni që shërbimi i kartës tuaj SIM është i disponueshëm.

### **Nuk mund të bëj telefonata**

- Sigurohuni se keni futuron një numër të vlefshëm dhe shtypni tastin .
- Për thirrje ndërkombëtare, kontrolloni shtetin dhe kodin e shtetit.
- Sigurohuni që telefoni juaj është i lidhur në një rrjet dhe që rrjeti nuk është i mbingarkuar ose i pa disponueshëm.
- Kontrolloni statusin e abonimit tuaj me operatorin tuaj (kredite, kartë SIM e vlefshme, etj.).
- Sigurohuni që nuk keni bllokuar thirrjet dalëse.
- Sigurohuni se telefoni juaj nuk është në regjim fluturimi.

### **Nuk mund të marr telefonata**

- Sigurohuni që telefoni juaj është ndezur dhe lidhur në një rrjet (kontrolloni për rrjet të mbingarkuar ose të pa disponueshëm).

- Kontrolloni statusin e abonimit tuaj me operatorin tuaj (kredite, kartë SIM e vlefshme, etj.).
- Sigurohuni që nuk keni pasuar thirrjet hyrëse.
- Sigurohuni që nuk keni bllokuar thirrjet të caktuara.
- Sigurohuni se telefoni juaj nuk është në regjim fluturimi.

### **Emri i marrësit/numri nuk shfaqen kur një thirrje është marrë**

- Sigurohuni që jeni abonuar në këtë shërbim me operatorin tuaj.
- Telefonuesi juaj ka fshehur emrin e tij/të saj ose numrin.

### **Unë nuk mund të gjej kontaktet e mi**

- Sigurohuni që karta juaj SIM nuk është thyer.
- Sigurohuni që karta juaj SIM është futur si duhet.
- Importoni të gjithë kontaktet e ruajtur në kartën tuaj SIM në telefon.

### **Kualiteti i tonit të telefonatave është i dobët**

- Ju mund të rregulloni volumin gjatë një telefonate duke shtypur tastin Lart/Duke thyer.
- Kontrolloni fuqinë e operatorit .
- Sigurohuni që marrësi, lidhësi ose mikrofoni në telefonin tuaj është i pastër.

### **Unë nuk mund të përdor veçoritë e përshkuara në manual**

- Kontrolloni me operatorin tuaj për tu siguruar që abonimi juaj e përfshin këtë shërbim.
- Sigurohuni që kjo veçori nuk kërkon një aksesor alcatel.

### **Kur unë zgjedh një numër nga kontaktet e mi, numri nuk mund të formohet**

- Sigurohuni që ju keni regjistruar korrektësisht numrin në skedarin tuaj.
- Sigurohuni që keni zgjedhur prefiksën e shtetit kur telefononi një shtet të huaj.

### **Nuk mund të shtoj një kontakt në kontaktet e mia**

- Sigurohuni që kontaktet e kartës tuaj SIM nuk janë plot; fshini disa skedarë ose ruani skedarët në kontaktet e telefonit.

### **Telefonuesit e mi janë të paaftë të lënë mesazhe në postën time zanore**

- Kontaktoni me operatorin e rrjetit tuaj për të kontrolluar disponueshmërinë e shërbimit.

### **Nuk mund të hap postën time zanore**

- Sigurohuni që numri i operatorit tuaj të postës zanore është futur saktë në "Mesazhe\Serveri i postës zanore".
- Përpiquuni më vonë nëse operatori është i zënë.



### **Ikona e dridhjes shfaqet në ekranin tim të gatishmërisë**

- Keni ruajtur tepër mesazhe të shkurtër në kartën tuaj SIM; fshini disa prej tyre ose arkivoni ato në kujtesën e telefonit.

### **PIN i kartës SIM i bllokuar**

- Kontaktoni operatorin e rrjetit tuaj për të siguruar kodin PUK (Çelës Personal Zhblokimi).

### **Nuk mundem të shkarkoj skedarë të rinj**

- Sigurohu nëse telefoni ka memorie të mjaftueshme për shkarkim.
- Zgjidh kartën microSD si vendruajtje të skedarëve të shkarkuar.
- Kontrolllo statusin e abonimit me operatorin tënd.

### **Telefoni nuk mund të zbulohet nga të tjerë nëpërmjet Bluetooth**

- Sigurohuni se Bluetooth është aktivizuar dhe se telefoni juaj është i dukshëm nga përdoruesit e tjerë.
- Sigurohuni që të dy telefonat janë brenda rrezes së zbulimit Bluetooth.

### **Si të bëni baterinë tuaj të zgjasë më gjatë**

- Sigurohuni të zbatoni kohë të plotë karikimi (minimumi 3 orë).
- Pas një karikimi pjesor, indikatori i nivelit të baterisë mund të mos jetë ekzakt. Prisi për të paktën 20 minuta pas heqjes së karikuesit për të siguruar një tregues ekzakt.
- Rregullo ndriçimin e ekranit sipas nevojës.
- Çaktivizo Bluetooth, kur nuk është në përdorim.

"Alcatel" është markë e "Alcatel-Lucent"  
dhe përdoret me licencë nga  
"TCL Communication Ltd."

© E drejta e autorit, 2017  
"TCL Communication Ltd."  
Të gjithë të drejtat e rezervuara

TCL Communication Ltd rezervon të drejtën  
të modifikojë materiale ose specififikimet  
teknike pa njoftim paraprak.